



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio 280/2016

**në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës dhe të privatësisë, të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes së banorëve të Komunës së Obiliqit dhe komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë**

Drejtuar:

- Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Z. Muharrem Nitaj, Kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor
- Z. Fatmir Matoshi, Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Z. Valdrin Lluka, Ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik
- Z. Uran Ismaili, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë
- Z. Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Z. Blerim Isufaj, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Z. Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit
- Z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës
- Z. Ilir Morina, Kryeshef i Agjencionit për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës
- Znj. Letafete Latifi, Drejtoreshë e Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës
- Z. Naser Ramadani, Drejtor i Institutit të Shëndetit Publik të Kosovës

Prishtinë, më 21 dhjetor 2018

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	3
Qëllimi i raportit.....	3
Kompetenca e Avokatit të Popullit .....	3
Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit .....	4
Baza kushtetuese, ligjore dhe instrumentet ndërkombëtare .....	9
Zona e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” .....	11
Ndotja e Ajrit.....	13
Ndotja e ujërave .....	16
Ndotja e tokës.....	16
Zhurma .....	17
Deponitë, adminstrimi i mbeturinave.....	18
Deponia e mbeturinave sanitare “Mirash” .....	19
Deponia e hirit.....	21
Shtëpia e banuar brenda hapësirës së KEK-ut.....	22
Mungesa e Bashkëpunimit ndërinstitucional dhe inspektorateve .....	23
Shqyrtimi i rasteve mjedisore brenda afateve të arsyeshme kohore në prokurori dhe gjykata dhe parashkrimi i tyre .....	24
Mungesa e informatave mjedisore .....	25
Mungesa e informatave shëndetësore.....	27
Përfundim.....	29

## Hyrje

Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka iniciuar procedura hetimore mbi bazën e detyrës zyrtare (*ex officio*) që nga 27 prill 2016 në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm; të drejtën e jetës dhe të privatësisë; të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive; të drejtën e pronës; lirinë e lëvizjes së banorëve të Komunës së Obiliqit dhe komunave të afërta të ndikuara nga problemi i njëjtë.

Sipas informatave të pranuar përmes burimeve të ndryshme, ankesave të qytetarëve, takimeve me kryetarin e Komunës së Obiliqit, raporteve të institucioneve dhe agjencioneve përkatëse për çështje mjedisore, mediave, Avokati i Popullit evidentoi një sërë problemesh mjedisore, me të cilat janë duke u ballafaquar qytetarët e hapësirave në fjalë.

Çështjet e evidentuara mjedisore janë: mungesa e monitorimit cilësor mjedisor, mungesa e qasjes në informata mjedisore dhe shëndetësore, rritja e numrit të të sëmurëve nga organet respiratore, nga sëmundjet kardiovaskulare dhe malinje, keq menaxhimi i deponisë së mbeturinave të Mirashit dhe deponive tjera, deponia e hirit, ndotja e ujit, e ajrit dhe e tokës, problemet e familjes së vendosur brenda pjesës së rrethuar nga KEK-u në fshatin Palaj, problemet e qytetarëve që banojnë rreth mihjes, shtëpitë e dëmtuara nga mihja, problemet me shpronësim të banorëve në zonën e interesit, ndërtimi i shtëpive/objekteve me qëllim të përfitimit nga shpronësimi, mosbashkëpunimi i organeve kompetente për të gjetur zgjidhje efektive për problemet mjedisore, si dhe vonesat e rasteve të inicuar në gjykatë.

### Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (KBPMPH), Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Policisë së Kosovës (PK), Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHP), dhe Komunës së Obiliqit (KO) për shkeljet e vazhdueshme të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ndotja dhe ndikimet në mjedis të faktorëve të ndryshëm në hapësirat e Komunës së Obiliqit dhe vendeve tjera të ndikuara nga problemet e lartpërmendura.

Gjatë periudhës dy vjeçare të monitorimit të çështjeve të evidentuara në raport, Avokati i Popullit, nuk ka vërejtur shumë ndryshime me tendencë përmirësimi.

Ky raport është punuar në bazë të informatave të marra në terren, bazuar në ankesat e qytetarëve të adresuara në IAP, informatat e pranuar në bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit nga Komuna e Obiliqit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës, nga takimet e drejtpërdrejta me Komisionin e Kuvendit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si dhe raporteve të institucioneve dhe agjencive përkatëse për çështje mjedisore.

### Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

2. Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes tjerash Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, paragrafi 4).
- tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (neni 18, nën paragrafi 1.2).
- të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18, nën paragrafi 1.5).
- t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18, nën paragrafi 1.6).

### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit**

3. Avokati i Popullit, më 28 prill 2016, takoi kryetarin e Komunës së Obiliqit, i cili e njoftoi për problemet mjedisore me të cilat është duke u ballafaquar kjo komunë dhe qytetarët e saj, si dhe pamundësitë buxhetore për të përmirësuar gjendjen. Sipas tij, shqetësuese është ngritja e numrit të të sëmurëve nga organet respiratore, kardiovaskulare dhe sëmundjet malinje. Ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës, ndotja akustike, e po ashtu emisionet nga KEK-u, janë çështje në vete. Po ashtu mungon qasja e vazhdueshme në informatat mjedisore, raportet e MMPH-së dhe ato të operatorit. Përpos deponisë regjionale të mbeturinave “Mirash”, në Komunën e Obiliqit janë të vendosura edhe deponia me mbeturina të rrezikshme të Trepçës dhe ajo në fshatin Mazgit e barnave të skaduara.

4. Më 28 prill 2016, Avokati i Popullit vizitoi deponinë e mbeturinave në Mirash, ku vërehej kundërmim dhe derdhje e ujërave të pa trajtuara, si rezultat i keq menaxhimit të mbeturinave.

5. Të njëjtën ditë Avokati i Popullit, vizitoi fshatrat pranë mihjes sipërfaqësore. Krugët që shpinin nga qendra e Obiliqit drejt fshatrave përreth ishin të mbushura me mbeturina të ndryshme, mbeturina inerte, hiri nga industria energjetike etj. Shiritat për bartjen e thëngjillit nuk ishin të sinjalizuara me shenja paralajmëruese, apo rrethojë mbrojtëse. Brenda rrethojës së KEK-ut gjendej shtëpia dhe prona e familjes Morina, e cila qasjen e kishte të penguar nga kontrolllet e sigurimit të KEK-ut. Çdo anëtar dhe çdo vizitor i familjes kontrollohej në çdo hyrje-dalje nga sigurimi i KEK-ut. Dy fëmijët e familjes, të moshës dy dhe tre vjeçare, ballafaqohen me probleme kronike të organeve respiratore, si rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë të ndotjes së shkaktuar nga mihja. Pronat e banorëve të përhershëm në fshatrat përreth mihjes ishin të rrezikuara nga rrëshqitjet e dheut, kurse procesi i shpronësimit kishte stagnuar për arsye të paqarta.

6. Në fshatin Shipitullë, që po ashtu gjendet në zonën e interesit, u vërejtën shumë shtëpi të ndërtuara së voni, shumica nga ato të pabanuara.

7. Të njëjtën ditë Avokati i Popullit deklaroi para mediave se për të gjitha shqetësimet do të iniciojë hetime lidhur me çështjen<sup>1</sup>. Sipas Avokati i Popullit duhet të ketë një strategji nacionale, një plan të mirëfilltë që qytetarët të dinë se cili është niveli i ndotjes në ambient, dhe nëse këto parametra janë në pajtueshmëri me ligjet që janë në fuqi.

8. Më 10 maj 2016, Avokati i Popullit u takua me drejtorin e krimeve të rënda dhe drejtorin e krimeve ekonomike në Policinë e Kosovës, me të cilët diskutoi problemet e evidentuara në Komunën e Obiliqit, dhe kërkoi që Policia të iniciojë procedura hetuese lidhur me çështjen.

9. Më 14 shtator 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës, ku njoftoi të pranishmit që institucioni është duke zhvilluar hetim për ndotjen e mjedisit, dhe ndikimin e ndotjes në të drejtat e qytetarëve në Obiliq dhe në komunat përreth. Edhe pse zona e mihjes është shpallë zonë e intresit nacional, trajtimin nuk e ka adekuat. Efekti i ndotjes nuk prek vetëm banorët e Obiliqit, por edhe qytetarët tjerë në komunat afër saj. AP-ja përmendi para të pranishmëve rastin e familjes Morina, e cila jeton në fshatin Palaj, dhe prona e tyre gjendet brenda hapësirës së rrethuar nga KEK-u, dhe liria e lëvizjes së tyre është e penguar nga vendosja e laurës së KEK-ut. Çdo hyrje-dalje në atë shtëpi kalon përmes pikës së kontrollit. Avokati i Popullit hapësirë të veçantë i kushtoi problemit të sëmundjes së fëmijëve të kësaj familjeje: *“Vetë fati i këtyre dy fëmijëve e meriton vëmendjen, jo vetëm të Komisionit, por edhe gjithë Kuvendit të Kosovës për të debatuar se cilat janë zgjidhjet”*. Meqenëse problemi ka vazhduar që nga viti 2004 e deri më tani, ky është problem kompleks, që ka të bëjë me të drejtën e jetës, të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, privatësinë, të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes etj, dhe s'i i tillë, tejkalon fuqinë e nje resori qeveritar dhe një operatori ekonomik për ta zgjidhur këtë problem, madje ka tejkeluar edhe fuqinë e një qeverie. Sipas AP-së forumi më i përshtatshëm për të diskutuar dhe për të gjetur zgjidhje është Kuvendi i Kosovës.

10. Më 22 shtator 2016, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Obiliqit, nga i cili kërkoi të njoftohet me veprimet e ndërmarra nga Komuna përkitazi me kompetencat e saj ligjore, që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore brenda kompetencave të nivelit lokal.

11. Më 29 shtator 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës, dhe potencoi se shpronësimi i pronave të banorëve të zonës së interesit të veçantë duhet të bëhet vetëm në bazë të ligjit.

12. Më 3 dhe 4 tetor 2016, përfaqësuesja e IAP-së, së bashku me grupin e përbërë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Policia e Kosovës, me ftesë të Komunës së Obiliqit, takuan menaxhmentin e “Kosovës A”, të “Kosovës B”, dhe të “Kosova Thëngjillit”. Në takim u kuptua se, në rastet kur janë regjistruar tejkalime të ndotjes, asnjëherë organet

<sup>1</sup> <http://koha.net/?id=8&l=110537>

kompetente nuk i kanë informuar qytetarët përkitazi me ndotjen, për të evituar daljet në minimum, për arsye të ndikimit të mundshëm në shëndet. Po ashtu, nga të njëjtët u kuptua se ata nuk kanë bërë asnjë kërkesë në Ministri të Shëndetësisë, si dhe në Institutin e Shëndetit Publik, në mënyrë që të kenë të dhëna shkencore për gjendjen shëndetësore të popullatës, përkundër zërave që për arsye të ndotjes, përqindja e të sëmurëve nga smundjet e organeve respiratore, kardiovaskulare dhe atyre malinje është në rritje.

13. Më 4 tetor 2016, Avokati i Popullit iu drejtua me letër ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, nga i cili kërkoi të njoftohet se a ka informata Ministria në kuadër të sistemit të informimit shëndetësor (SISH), lidhur me rritjen e numrit të qytetarëve të prekur nga sëmundjet e organeve të frymëmarrjes, të sëmundjeve kardiovaskulare dhe të atyre malinje për territorin në fjalë, pasi që, sipas informatave të ndryshme, informatave të Komunës së Obiliqit, rezulton se përqindja e qytetarëve të prekur me sëmundjet e lartpërmendura është më e lartë në krahasim me pjesët e tjera të vendit.

14. Më 4 tetor 2016, Avokati i Popullit iu drejtua me letër drejtorit ekzekutiv të Institutit të Shëndetit Publik, nga i cili kërkoi të njoftohet se a ka informata instituti lidhur me rritjen e numrit të qytetarëve të prekur nga sëmundjet e organeve të frymëmarrjes, të sëmundjeve kardiovaskulare dhe të atyre malinje në territorin në fjalë, pasi që, sipas informatave të ndryshme, rezulton se përqindja e qytetarëve të prekur është më e lartë, në krahasim me pjesët e tjera të vendit.

15. Më 6 tetor 2016, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Obiliqit, me të cilën IAP-ja u njoftua lidhur me veprimet e ndërmarra nga Komuna për çështjet që ndërliken me objektin e shqyrtimit të këtij raporti.

16. Më 11 tetor 2016, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës, nga e cila u njoftua përkitazi me veprimet e ndërmarra brenda kompetencave të tyre.

17. Më 13 tetor 2016, Avokati i Popullit lëshoi Opinion lidhur me gjendjen në hapësirat e zonës së interesit të veçantë ekonomik, sipas Vendimit nr. 4/119, datë 3 nëntor 2004 dhe Vendimit 02/57, datë 13 mars 2009 të Qeverisë së Kosovës, me propozimin për ndërmarrjen e masave efektive për zgjidhjen e çështjes. Sipas Avokatit të Popullit, edhe pse gjendja mjedisore është larg standardeve të dëshirueshme, dhe normat e ndotjes, sipas raporteve ekzistuese, shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor, me mundësi të ndikimit negativ në shëndetin e qytetarëve. Zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e popullatës nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, që nga viti 2004 nuk është kryer përkundër obligimit pozitiv të shtetit për veprim. Banorët në vazhdimësi janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen me ndotje të ajrit, të ujit dhe të tokës, zhurmë dhe vibrime nga operimi i makinerisë së rëndë, ndërsa organet kompetente kanë vazhduar të qëndrojnë në heshtje, të mos përpiqen të gjejnë zgjidhje karshi një situatë të paqartë, në të cilën nuk ka përmirësim, por gjithnjë me tendencë përkeqësimi.

18. Më 13 tetor 2016, Avokati i Popullit në emisionin Jeta në Kosovës, të titulluar "*Tokat mbi Qymyr*", përkitazi me çështjen e vendbanimeve pranë mihjes në Shipitullë dha mendimin se askush nuk mund të garantojë dhe të sigurojë që nuk do të ketë rrëshqitje të dheut, dhe nuk do të mund të humbë jetën ndonjë qytetarë, pasi që në pusët e ujit në pronat e banuara mund

të shihet se si ka rrëshqitur dheu. Avokati i Popullit deklaroi se kudo që shikon vërehet degradim i ambientit, gjë që është qasje e papranueshme e shtetit në raport me hapësirën në fjalë, duke pasur parasysh vendndodhjen edhe të deponive tjera, duke krijuar një mjedis jashtëzakonisht të ndotur, që e ka sjellë hapësirën në një situatë që do të mund ta ndërronte emrin në “Çernobil”.

19. Më 14 tetor 2016, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, nga e cila u njoftua përkitazi me veprimet e ndërmarra brenda kompetencave të tyre.

20. Më 21 tetor 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e ftuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës, ku përsëriti se të drejtat dhe liritë e njeriut janë duke u cenuar, dhe se shpronësimi duhet të bëhet i bazuar në ligj. Nëse vendoset që shpronësimi të bëhet bazuar në Kornizën e Politikave të Zhvendosjes e Republikës së Kosovës për zonën fusha e Mihjes së Re, atëherë, dokumentit duhet t'i jepet fuqia e ligjit.

21. Më 21 nëntor 2016, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga MMPH-ja, nga e cila u njoftua përkitazi me veprimet e ndërmarra brenda kompetencave të tyre, sipas pyetjeve të parashtruara nga Avokati i Popullit.

22. Avokati i Popullit, në raportin vjetor 2016, paraqiti problemet lidhur me çështjen e raportit.

23. Më 13 mars 2017, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e ftuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në Kuvendin e Kosovës, ku u diskutua vendimi i Komisionit për miratimin e ligjit të ri të quajtur “Ligji për Haden”. Qëllimi i Ligjit është rregullimi i procedurave të kompensimit, shpronësimit dhe zhvendosjes të banorëve të hapësirave të zonës së interesit të veçantë ekonomik sipas Vendimit nr. 4/119, datë 3 nëntor 2004 dhe Vendimit 02/57, datë 13 mars 2009. Qëndrimi i Avokatit të Popullit lidhur me vendimin e Komisionit për “Ligjin për Haden” ishte si në vijim: Tashmë ekziston ligji bazë për shpronësimin. Nxjerrja e ligjit të ri do të konsumojë kohë dhe më tej do të zvarritë çështjen. Ligji i ri nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin për shpronësimet. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Shpronësimin janë bazë e mjaftueshme për kryerjen e procesit të kompensimit, të shpronësimit dhe të zhvendosjes së banorëve të hapësirave në fjalë”. Posaçërisht duhet të kemi parasysh obligimin kushtetues që buron nga neni 53 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sipas së cilit të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, duhet të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta dhe Ligji për Shpronësimin japin përgjigje të mjaftueshme në drejtim të përfundimit të shkëlqeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut. Komisioni tashmë ka bërë punën e vet dhe nuk është në kompetencën e Komisionit të Kuvendit të gjejë zgjidhjen, por është kompetencë e Qeverisë. Avokati i Popullit i rekomandoi Komisionit: Që të ftojë kryeministrin e Republikës së Kosovës, që të ndërmarrë veprime, që çështjen e Hades ta vendosë në rend dite në takimin e qeverisë; që çështja të ngritet në komisionin ndërministror për të drejtat e njeriut, për t'i diskutuar veprimet e ndërmarra nga qeveria, në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit; që Qeveria eventualisht të njoftojë Kuvendin në seancë plenare lidhur me veprimet e ndërmarra në drejtim të zgjidhjes së çështjes.

24. Më 14 mars 2017, Avokati i Popullit iu drejtua Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës me rekomandime për zgjidhjen e problemit të shpronësimit/zhvendosjes së banorëve të hapësirave në zonën e interesit të veçantë ekonomik, drejtuar Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës, sipas Vendimit nr. 4/119, datë 3 nëntor 2004 dhe Vendimit 02/57, datë 13 mars 2009.
25. Më 28 maj 2017, Avokatit të Popullit me bashkëpunëtorë, i shoqëruar edhe nga një ekspert i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, si dhe zyrtarë të Komunës së Obiliqit, vizituan fshatin Dardhishtë të Komunës së Obiliqit, respektivisht pikat e derdhjeve hidraulike nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” në lumin Sitnica. Vizita u bë me qëllim që të shihet nga afër shkarkimi ujërave me ndotje industriale, të bëhet matja e nivelit të Ph-së në këto dy pika dhe të bëhet marrja e mostrave për të analizuar më detajisht nivelin e ndotjes.
26. Më 28 maj 2017, Avokati i Popullit, publiko komunikatën për media përmes së cilës njoftoi publikun lidhur me të gjeturat e shkarkimeve të ujërave me ndotje industriale, respektivisht pikat e derdhjeve hidraulike nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” në lumin Sitnica.
27. Më 28 qershor 2017, Avokati i Popullit iu drejtua me letër ministrit të atëhershëm të Mjedisit, nga i cili kërkoi të njoftohet lidhur me rezultatet e dala nga analizat e mostrave të marra më 24 mars dhe 28 maj 2017, dhe veprimet që janë ndërmarrë nga Ministria si organ kompetent lidhur me këtë çështje.
28. Avokati i Popullit, në raportin vjetor 2017, paraqiti problemet lidhur me çështjen e raportit.
29. Më 12 janar 2018, Avokati i Popullit takoi ministren e atëhershme znj. Reshitaj, me të cilën diskutoi lidhur me çështjet e ngritura në raport.
30. Më 30 janar 2018, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës, në të cilin morën pjesë përfaqësues institucionalë për shëndetësi, mjedis dhe të ambientit hapësinor. Në këtë takim u diskutua lidhur me shkaktarët e ndotjes alarmante të ajrit, në periudhën dhjetor 2017 - janar 2018. Avokati i Popullit, deklaroi se institucionet kompetente nuk janë duke e zbatuar ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
31. Më 30 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër ministrit të atëhershëm të MMPH-së, nga i cili kërkoi të njoftohet lidhur me rezultatet e dala nga analizat e mostrave të marra më 24 mars dhe 28 maj 2017, dhe veprimet që janë ndërmarrë nga Ministria si organ kompetent lidhur me këtë çështje.
32. Më 31 janar dhe 1 shkurt 2018, Kuvendi i Kosovës mbajti seancën e jashtëzakonshme lidhur me ndotjen e ajrit në Komunën e Prishtinës. Gjatë dy ditëve, shumë nga deputetët theksuan pjesën e raportit vjetor ku flitej për ndotjen e ajrit në Komunën e Prishtinës dhe të Obiliqit.
33. Më 4 prill 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës nxori vendimin nr. 05/39, me të cilin formohej grupi i ri punues teknik që kishte për qëllim zhvillimin e Minierës së re të Korporatës Energjetike.



34. Më 18 maj 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga ministrja e atëhershme e MMPH-së.

35. Më 4 korrik 2018, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e mbajtur nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, ku ngriti çështjen e shpronësimit të pronave të banorëve të zonës së Shipitullës dhe Hadës, duke vlerësuar se janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Avokati i Popullit paraqiti qëndrimin e tij që shpronësimi duhet të jetë i bazuar në ligj.

36. Më 15 gusht 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit takoi kryeshefin e Kompanisë për menaxhimin e deponisë së mbeturinave në Kosovë, me të cilin diskutoi çështjen e menaxhimit të deponisë së Mirashit.

37. Më 7 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime lidhur me mosarritjen e organeve kompetente për të përmbushur obligimet për menaxhimin e materialeve me përmbajtje asbesti brenda territorit të vendit. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve kompetente, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe komunave, për nevojën e ndërmarrjes së masave të menjëhershme parandaluese, në mënyrë që të reduktohen efektet negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

38. Më 22 nëntor 2018, Avokatit të Popullit, organizoi tryezën “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”. Qëllimi i të cilës ishte diskutimi i arsyes së zvarritjes së lëndëve mjedisore në Prokurori dhe Gjykatë. Nga diskutimi u kuptua se as sistemi prokurorial dhe as ai gjyqësor nuk kanë statistika lidhur me këto raste, nuk është diskutuar asnjëherë lidhur me çështjen, dhe që krimet mjedisore zakonisht lidhen me rastet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, dhe që numri i rasteve të mjedisore është i vogël.

39. Çështja e cenimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve në këto hapësira është ngritur si shqetësim në vazhdimësi nga Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, në takime e mbajtura në Kuvendin e Kosovës, në institucionet tjera përgjegjëse, në aktivitete si dhe në media.

### **Baza kushtetuese, ligjore dhe instrumentet ndërkombëtare**

40. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] i garanton secilin qytetar, të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, duke e mëveshur secilin me petkun e përgjegjësisë, pa përjashtuar as institucionet, e as ndërmarrjet publike. “Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”.

41. Avokati i Popullit, gjatë analizës së këtij rasti mjedisor vlerëson se çështja në fjalë që ka të bëjë më të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, prek të drejtën e jetës<sup>2</sup>, të drejtën e privatësisë<sup>3</sup> dhe familjes, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën për qasje në dokumente publike, të drejtën e pronës, dhe dinjitetin e qytetarëve.

---

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 25 [E Drejta për Jetën].

<sup>3</sup> Neni 36, [E Drejta e Privatësisë],

42. Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]: “*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*”.
43. Neni 24 [Barazia para Ligjit] “*1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*”.
44. Neni 3, par. 2 [Barazia para Ligjit]: “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre*”.
45. Neni 25 [E Drejta për Jetën]: “*1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën*”.
46. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].
47. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*”.
48. Neni 35 [Liria e Lëvizjes]: “*1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës...*”.
49. Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]: “*1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera*”.
50. Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]: “*1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike*”.
51. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]: “*1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose për krahejen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet*”.
52. Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
53. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
54. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, (në vazhdim Konventa), neni 2 [E drejta për jetën].
55. Neni 6 i Konventës [E drejta për një proces të rregullt]: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një*

*gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile... ”.*

56. Neni 8 i Konventës [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]: *“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe... ”.*

57. Neni 10 i Konventës [Liria e shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë”;*

58. Neni 13 i Konventës [E drejta për zgjidhje efektive]: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

59. Neni 1, Protokolli 1 i Konventës [Mbrojtja e pronës]: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji... ”.*

60. Neni 2, Protokolli 4 i Konventës [Liria e lëvizjes]: *“Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij”.*

#### **Zona e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”**

61. Avokati i Popullit si problem madhor e kategorizon çështjen e cenimit të vazhdueshëm të të drejtave të njeriut të banorëve të zonës me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”.

62. Qeveria e Kosovës, më 3 nëntor 2004, përmes Vendimit nr. 4/119, shpalli tokat e fshatit Hade, Sibovc, Leshkoviç dhe Cërna Vodice të komunës së Obiliqit, si zonë të interesit të veçantë. Vendimi në nenin II, obligoi Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Kuvendin Komunal të Obiliqit të ndalojë ndërtimet dhe mbindërtimet e reja.

63. Më 13 mars 2009, Qeveria e Kosovës lëshoi Vendimin tjetër nr. 02/57, përmes të cilit shpalli zonë të interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”, me një sipërfaqe prej 143,254 km<sup>2</sup> e cila përfshiu zonat kadastrale të Obiliqit, Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Drenasit.

64. Procesi i zhvendosjes dhe i shpronësimit i disa lagjeve në fshatin Hade është përcjellë me mungesë të informimit, duke krijuar te qytetarët ka paqartësi për procesin e shpronësimit. Hapësira e dedikuar për zhvendosjen e banorëve e quajtur Hadja e Re, asnjëherë nuk është kompletuar me infrastrukturë për banim, e cila do të siguronte dhe do t’u garantonte banorëve kushte të dinjitetshme dhe cilësore të banimit.

65. Ndërtimet e reja ilegale në zonat e interesit vazhduan në fshtin Hade, e po ashtu me hapa të përshpejtuar në Shipitullë, pa u penguar<sup>4</sup>. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit

---

<sup>4</sup> Vendimi i Qeveria e Kosovës, nr. 4/119, 3 nëntor 2004, nenin II, obligoi Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Kuvendin Komunal të Obiliqit të ndalojë ndërtimet dhe mbindërtimet e reja.

Hapësinor, e po ashtu Komuna e Obiliqit, dështuan t'i ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për kontrollimin dhe ndalimin e ndërtimeve në zonat e interesit të veçantë.

66. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka pranuar në vazhdimësi ankesa nga qytetarët që jetojnë në zonën e interesit të veçantë, me pretendim se të drejtat dhe liritë e tyre janë duke u cenuar, pas shpalljes së vendbanimeve të tyre zonë të interesit të veçantë. Natyra e ankesave është e ndryshme, si: dëmtimi i pronës, mos shpronësimi, ndalimi i ndërtimit, problemet me zhurmën, ndikimi i mihjes në shëndetin e banorëve, problemet sociale etj.

67. Bazuar në hetimet e bëra në terren dhe informatave të tjera të pranuar nga burime të ndryshme, vërehet që veprimtaria e mihjes në fshatrat Hade dhe Shipitullë ka vështirësuar jetën e banorëve. Edhe pse gjendja mjedisore është larg standardeve të dëshirueshme, dhe normat e ndotjes, sipas raporteve ekzistuese, shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor, me mundësi të ndikimit negativ në shëndetin e qytetarëve, përkundër obligimeve pozitive të shtetit, zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e popullatës nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, që nga viti 2004, nuk është kryer.

68. Përderisa banorët në vazhdimësi janë ballafaquar dhe vazhdojnë të jetojnë në ankth nga rrëshqitjet e mundshme të dheut, dëmtimet e pronës, ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, zhurma dhe vibrimet nga operimi i makinerisë së rëndë, organet kompetente kanë vazhduar të qëndrojnë në heshtje, të mos përpiqen të gjejnë zgjidhje karshi një situatë të paqartë, pa ndonjë përmirësim, por me tendencë përkeqësimi.

69. Përveç, ndikimit negativ në mjedis, moszgjidhja e situatës me masa efektive ka ndikuar negativisht në mirëqenien ekonomike të banorëve. AP-ja vëren që dështimi i shtetit dhe operatorit për të investuar, apo për të investuar mjaftueshëm, në proporcion me dëmin e shkaktuar në mjedis, dhe në infrastrukturën e trashëguar brenda hapësirave në fjalë, ka krijuar mjedis jo të sigurt për jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

70. Nga hetimet dhe analizat e bëra në IAP, ka rezultuar që qytetarët e këtyre hapësirave janë lënë në një situatë *Limbo*, pasi që shteti nuk ka arritur të përmbushë obligimin e tij pozitiv të paraparë me Kushtetutë dhe ligje, karshi qytetarëve për të respektuar të drejtat e tyre, të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës, privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë/pronës etj., madje edhe lirinë e lëvizjes.

71. Avokati i Popullit konsideron që banorët në fjalë janë vënë në pozitë të pabarabartë, me qytetarët tjerë të Kosovës. Shteti duke mos u përpjekur të gjejë zgjidhje konkrete për banorët në fjalë, ka dështuar të përmbushë obligimin ligjor, të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm<sup>5</sup>.

72. Edhe pse njëra ndër tri parimet përmes së cilave realizohen të drejtat mjedisore, Parimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, i paraparë në Konventën Aarhus, dhe po ashtu e drejtë e paraparë me Kushtetutë, në këtë proces është përcjellë me vështirësi.

---

<sup>5</sup> Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 1, "Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm".

73. Shqetësim i Avokatit të Popullit është planifikimi i zhvendosjes së banorëve<sup>6</sup>, përmes dokumenteve që nuk kanë fuqi ligjore. Dokumenti i quajtur Korniza e Politikave për Zhvendosje e Republikës së Kosovës për Zonën e Fushës së Mihjes së Re, përkufizon politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zhvendosjen e popullatës që do të duhej të rilokohej për shkak të zhvillimit të aktiviteteve të rëndësishme infrastrukturore dhe minerare, për të cilat është i domosdoshëm përvetësimi i pronave të paluajtshme, është dokument, cili, edhe pse në mënyrë të detajuar, parasheh mënyrën e zhvendosjes së popullatës, nuk e ka fuqinë e ligjit.

74. Avokati i Popullit, në takimin e datës 4 korrik 2018, të mbajtur në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës, ngriti çështjen e shpronësimit të pronave të banorëve të zonës së Shipitullës dhe Hadës, duke vlerësuar se janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Në takim nuk u arrit të merr përgjigje nga ministri i Ministrisë së Energjetikës se cilët janë anëtarët e grupit punues të zgjedhur sipas vendimit nr. 05/39, të datës 4 prill 2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili kishte për qëllim zhvillimin e Minierës së re të Korporatës Energjetike. Sipas Avokati i Popullit, çdo vendim për zgjidhjen e çështjes së zhvendosje, apo shpronësimit, në mënyrë që të jetë efektiv, duhet të jetë i bazuar vetëm në ligj.

#### **Ndotja e Ajrit**

75. Edhe përkundër ankesave të vazhdueshme të qytetarëve përkitazi me problemin e ndotjes së ajrit, në Komunën e Obiliqit dhe komunat e afërta, në veçanti lidhur me shkarkimet nga KEK-u, gjatë periudhave të caktuara të ditës, dhe në ditë të caktuara, organet kompetente përkundër obligimit të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja<sup>7</sup>, nuk kanë arritur të sigurojnë monitorim cilësor, i cili do të prezantonte informata të besueshme dhe bindëse për gjendjen e ajrit.

76. Bazuar në informatat e kryeshefit të AMMK-së, në Komisionin e Kuvendit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në takimin e datës 13 nëntor 2018, u kuptua se ndotësi kryesor është energjetika.

77. Sipas Raportit për gjendjen e Mjedisit të AMMK-së, të vitit 2016, Komuna e Obiliqit dallon nga vendet tjera me 90 ditë tejkalime të VML brenda vitit, nga ndotja e theksuar nga pluhuri në formë të PM10 dhe PM2.5<sup>8</sup>. Vërehet se sipas vlerësimeve të emisioneve në

---

<sup>6</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", "Vendbanimet në pika të nxehta - që preferohen ti nënshtrihen procesit deri në zhvendosje. Në këtë grup, kemi të bëjmë me vendbanimet që janë brenda trekëndëshit të ndikimeve degraduese (në mes të pikave të nxehta), që ndikohen direkt nga objektet për gjenerim të energjisë elektrike, deponitë e hirit dhe palosjet e jashtme si dhe nga avancimi i zhvillimeve minerare dhe deponi rajonale e mbeturinave dhe nënvizohen këto: Krusheci (apo Dardhishtë, me rreth 6.6 km<sup>2</sup> dhe 2.210 banorë) – K. Obiliq, Caravadica (apo Palaj, me rreth 7.1 km<sup>2</sup> dhe 1.150 banorë) – K. Obiliq dhe Lagjia e Berishëve në Graboc të Poshtëm – K. Fushë Kosovë".

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Neni 33, Monitorimi "1. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet nga Ministria, e cila siguron monitorimin e përhershëm të cilësisë së ajrit dhe ndikimin në mjedis dhe shëndetin e popullatës".

<sup>8</sup> <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs313/en/>, PM prek më shumë njerëz se çdo ndotës tjetër. Komponentët kryesore të PM janë sulfat, nitrateve, amoniak, klorur natriumi, karboni i zi, pluhur mineral dhe ujë. Ajo përbëhet nga një përzierje komplekse e grimcave të ngurta dhe të lëngshme të substancave organike dhe inorganike pezull në ajër. Grimcat më të mëdha për shëndetin, janë ato me diametër prej 10 mikronë ose më pak, (≤ PM10), të cilat mund të depërtojnë thellë brenda mushkërive. Ekspozimi kronik në grimca

Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” për vitin 2015, janë regjistruar tejkalime të emisioneve të pluhurit në mg/Nm<sup>3</sup>, tejkalime të emisioneve të SO<sub>2</sub> në mg/Nm<sup>3</sup><sup>9</sup>, dhe emisionet e NO<sub>x</sub> në mg/Nm<sup>3</sup><sup>10</sup>, gjatë tërë vitit.

78. Bazuar në informatat e pranuar nga MMPH, metodologjia e monitorimit të cilësisë së ajrit dallon në mes të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) dhe KEK-ut. IHMK bën monitorim kontinual të cilësisë së ajrit në 3 stacione (Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj), ndërsa KEK-u ka sistem parcial të monitorimit të cilësisë së ajrit për DPQ (Divizioni për Prodhim të Qymyrit). Monitorimin e bën Instituti INKOS<sup>11</sup>. Nuk ka matje të vazhdueshme mbi NO<sub>x</sub>-in.

79. Monitorimi i bërë nga operatori, bëhet përmes metodologjisë jo adekuate dhe jo në harmoni me kërkesat e legjislacionit nacional e ndërkombëtar<sup>12</sup>. Asnjëherë nuk është evidentuar rast kur është prekur pragu i alarmit<sup>13</sup>, është tejkaluar apo përcaktuar cilësi e dobët e ajrit. Madje organet kompetente nuk kanë ndërmarrë veprime paralajmëruese për t’i informuar autoritetet relevante lokale dhe publikun, përkundër obligimit ligjor<sup>14</sup>.

80. Avokati i Popullit gjen që GJEDNJ, në rastin *Guerra and Others v. Italy*, ka vlerësuar që ndotja e mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe të parandalojë gëzimin e shtëpisë, në mënyrë të tillë, duke ndikuar negativisht në jetën private dhe familjare.

81. Sipas informatave të pranuar nga MMPH, rastet e inicuar në gjykatë kundër ndotësve të mjedisit, pas evidentimit të shkeljeve nga inspektorati i ministrisë, janë parashkruar nga ana e gjykatave.

82. Nga krahasimi i përgjigjeve të pranuar përmes përgjigjes së MMPH-së, lidhur me pyetjen e Avokatit të Popullit, se “A i ka ofruar operatori në vazhdimësi raportet për shkarkimin e emisioneve”, vëren një tentim për shmangie nga përgjigjja duke pranuar përgjigje jo konkrete: “Operatori është i obliguar që të bëjë monitorimin dhe raportimin mujor të shkarkimeve të emisioneve”.

---

kontribuon në rrezikun për zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, si dhe atyre të kancerit të mushkërive.

<sup>9</sup><http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs313/en/>, SO<sub>2</sub> mund të ndikojë në sistemin e frymëmarrjes dhe funksionet e mushkërive, dhe shkakton acarim të syve. Inflamacion i traktit respirator shkakton kollitje, sekretim të mukusit, përkeqësim të astmës, bronkit kronik dhe i bën njerëzit më të prirur për infeksioneve të traktit respirator. Ka shtrime në spital për sëmundje kardiake dhe mortalitet në rritje në ditët me nivele më të larta të SO<sub>2</sub>. Kur SO<sub>2</sub> kombinon me ujë, formon acid sulfurik; ky është komponenti kryesor i shiut acid i cili është një shkak i shpyllëzimit.

<sup>10</sup> <http://www.icopal-noxite.co.uk/nox-problem/nox-pollution.asp>, NO<sub>x</sub> kryesisht ndikon në rrugët e frymëmarrjes duke shkakuar inflamacion të rrugëve të frymëmarrjes.. Ekspozimi afatgjatë mund të ulet funksionin e mushkërive, të rrisë rrezikun e rrugëve të frymëmarrjes dhe rrit predospozitat ndaj alergeneve. NO<sub>x</sub> gjithashtu kontribuon në formimin e grimcave (PM) dhe ozonit tokësor, të cilat të lidhura së bashku shkaktojnë efekte negative shëndetësore.

<sup>11</sup> Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH-së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016,

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit Nga Ndotja, neni 2, par.1.23, Pragu i alarmit - niveli përtej së cilës ekziston rreziku për shëndetin e njeriut nga ekspozimi i shkurtër i ndotjes për të cilën duhet të ndermirren masat e menjëhershme;

<sup>14</sup> Po aty, neni 24, par. 1 “Kur pragu i alarmit tejkalohe dhe përcaktohet cilësi e dobët e ajrit, Ministria përcakton masat paralajmëruese dhe informon Qeverinë, autoritetet relevante lokale dhe publikun.

83. Ndërsa në pyetjen e AP-së se “A i posedoni raportet e dorëzuara nga operatori, për 3 vitet e fundit. Nëse po, ju lusim që të na i dërgoni”, AP ka pranuar përgjigje: “AMMK-ja i posedon të gjitha raportet e dorëzuara nga operatori në formë elektronike dhe të fortë”, mirëpo raportet nuk i janë ofruar AP-së.

84. Lidhur me pyetjen “A ka pasur rast kur nuk janë ofruar raportet nga operatori?”. AP ka pranuar përgjigje: “Prej vitit 2013 deri në vitin 2015 nuk mungon asnjë raport mujor nga KEK-u”. Avokati i Popullit, përveç që konstaton që përpiluesi i përgjigjeve ka neglizhuar mandatin dhe kompetencat e AP-së, duke harruar që nuk është viti 2015, por 2016. Mirëpo, AP në momentet e fundit para përfundimit kupton që nuk ka pranuar përgjigje të saktë nga MMPH, pasi që kryeshefi ekzekutiv i AMMK-së deklaroi publikisht në emisionin “Puls” të KTV-së: “Ne si Agjenci kemi bërë kallëzim penal KEK-ut për mosraportim të ndotjes”. Z. Morina në emision ka paraqitur edhe dokumentin që dëshmon një gjë të tillë.

85. Më 30 janar 2018, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës, në të cilën morën pjesë përfaqësues institucionalë për shëndetësi, mjedis dhe ambientit hapësinor. Në këtë takim u diskutua lidhur me shkaktarët e ndotjes alarmante të ajrit, në periudhën dhjetor 2017 - janar 2018. Avokati i Popullit, para të pranishmëve kërkoi arsye se pse asnjë nga masat e parapara në nenin 24 të Ligjit nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, për tejkalimin e pragut të alarmit dhe cilësinë e dobët të ajrit nuk janë zbatuar. Ai po ashtu shfaq shqetësimin se pse dispozitat për shqiptimin e gjobave mandatore të parapara në ligj, nuk zbatohen.

86. Më 1 shkurt 2018, pas seancës dy ditore lidhur me ndotjen e ajrit, Kuvendi i Kosovës, miratoi rezolutën kundër ndotjes së ajrit, të përbërë nga 19 pika<sup>15</sup>. Duke marr parasysh që 11 muaj pas, gjendja e ajrit mbetet pothuaj e njëjtë, me rrezik në jetën dhe shëndetin e qytetarëve<sup>16</sup> rezoluta vërehet se është mjet e joefektiv juridik.

87. Avokati i Popullit gjen se gjykata në rastet *Öneryıldız v. Turkey*, par. 93 dhe *Budayeva and Others v. Russia*, par. 140, ka theksuar se rastet që në veçanti kanë të bëjnë me veprimtari të rrezikshme, kur autoritetet publike janë plotësisht të vetëdijshme për pasojat e mundshme dhe nuk i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për evitimin e rrezikut, duke mos arritur të marrin masa që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'i shmangur rreziqet që mund të shkaktojnë edhe humbje të jetës, dhe shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, kërkohet që përgjegjësit për rrezikim të jetës të ngarkohen me vepër penale apo të ndiqen penalisht.

88. Duke shprehur skepticizmin lidhur me relevancën dhe kualitetin e të dhënave të lartpërmendura dhe duke marrë parasysh që monitorimi i bërë nga operatori, bëhet përmes metodologjisë joadekuate dhe jo sipas kërkesave të parapara me legjislacionin vendor e ndërkombëtar, e mbi të gjitha, të dhënat të cilat merren nga operatori, nuk kontrollohen nga shteti dhe kryhen nga një institut i pa licencuar<sup>17</sup>, Avokati i Popullit konstaton se Ministria nuk ka arritur të sigurojë një sistem të sigurt për monitorimin e aktiviteteve të operatorit, e sidomos emisioneve, që mund të kenë elemente që paraqesin rrezik për jetën e banorëve.

<sup>15</sup> <https://www.koha.net/arberi/72950/kuvendi-miraton-rezoluten-per-ndotjen-e-ajrit/>

<sup>16</sup> Sipas matjeve të Konsulatës të SHBA, më 20 dhjetor 2018, PM2.5, 338, e velerësuar e rrezikshme.

<sup>17</sup> Informatë e pranuar nga përfaqësuesi i komunës së Obiliqit, në takimin e datës 4 tetor 2016.

## Ndotja e ujërave

89. Sipas informatave që i posedon IAP, vazhdon ndotja e lumit Sitnicë, në veçanti pranë zonës së interesit nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij, nga shkarkimet urbane, e po ashtu nga fluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit. Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë vëllim të madh të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose shumë pak trajtim të ujërave të zeza<sup>18</sup>.

90. Shfrytëzuesit më të mëdhenj të ujit sipërfaqësor janë TC- Kosova A dhe B, duke shfrytëzuar edhe lumin Llap. Përkundër rëndësisë së mbrojtjes së ujërave, AP ka vërejtur se nuk ka analiza dhe informata të mjaftueshme për trajtimin e ujërave shkarkues<sup>19</sup>.

91. Përkundër gjendjes së krijuar, por edhe madhësisë së sipërfaqes së zënë nga KEK-u, vërehet që parimi *ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan* nuk zbatohet. Operatori nuk paguan për shfrytëzimin e ujërave dhe shkarkimin e tyre<sup>20</sup>.

92. Më 28 maj 2017, Avokatit të Popullit me bashkëpunëtorë, i shoqëruar edhe nga një ekspert i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, si dhe zyrtarë të Komunës së Obiliqit, vizituan fshatin Dardhishtë të Komunës së Obiliqit, respektivisht pikat e derdhjeve hidraulike nga Termocentralet Kosova A dhe Kosova B në lumin Sitnica. Vizita u bë me qëllim që të shihet nga afër shkarkimi i ujërave me ndotje industriale, të bëhet matja e nivelit të Ph-së në këto dy pika dhe të bëhet marrja e mostrave për të analizuar më detajisht nivelin e ndotjes.

93. Edhe pse Avokati i Popullit kërkoi në vazhdim përgjigje se cilat masa janë ndërmarrë lidhur me çështjen, MMPH-ja, si organ kompetent, nuk e njoftoi asnjëherë Avokatin e Popullit detajisht lidhur me çështjen.

## Ndotja e tokës

94. E drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në territorin në fjalë, është duke u kufizuar nga ndotja dhe degradimi i dheut. Ekziston ndotje e dheut në zonën e ish-objekteve industriale energjetike, në lokacionin në afërsi të TC Kosova A, depozitim i mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike), deponimi i hirit të TC Kosova A, si dhe mbetjet nga punimet e vjetra minerare nëntokësore. Burimet kryesore potenciale të identifikuar të kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësore janë: derdhjet e substancave vajore dhe materieve tjera kimike, veçanërisht në lokacionet e stabilimenteve të mëhershme të gazifikimit dhe azotikut; shirat acidike, aerosolet dhe grimcat e suspenduara nga termocentralet, aktivitetet e mihjeve si dhe deponitë e hirit (më parë ka pasur edhe depozitime të ndotësve nga impiantet e vjetra të gazifikimit dhe azotikut); deponimi i mëparshëm dhe aktual i mbeturinave në deponi të hirit, në veçanti në deponinë e hirit të Kosovës A dhe në

<sup>18</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re".

<sup>19</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", dhe Informatë e pranuar nga përfaqësuesit e MMPH, komuna e Obiliqit, dhe menaxhmenti i KEK. Datë, 3 dhe 4 tetor 2016.

<sup>20</sup> Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Neni 85, Burimet financiare "1. Mjetet financiare për administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e ujërave sigurohen nga, 1.1.pagesa për shfrytëzimin e ujërave; 1.2.pagesa për shkarkimin e ujërave;



minierën e vjetër (deponia sanitare rajonale); dhe shkarkimet e ujërave të pa trajtuara industriale dhe të zeza<sup>21</sup>.

95. Sipas raportit të datës 12 prill 2014, të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, i dalë në bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit, për të inspektuar pronën e familjes Kutlllovci, në Dardhishtë, në bazë të analizave fiziko kimike të ujërave rrjedhëse nga deponia e hirit të KEK-TCA, dhe ujërave nëntokësore, nga analiza e ujit të marrë në kanalën shkarkues nga deponia TCA, te ura e hekurudhës, prezencë e fenoleve, në nivelin 0.345 mg/L, i tejkalon vlerat e të gjitha kategorive të dhëna në UA 13/2008, ndërsa sipas raportit vlerat e joneve nitrite janë mjaft të padëshiruara. Nga analiza e ujit të marrë në kanalën shkarkues nga deponia TCA, te ura e lagjes së Gjigollëve, vlera e shënuar e fenoleve është 0.680, po ashtu edhe jonet nitrite kanë regjistruar vlerë të lartë<sup>22</sup>.

96. Sipas Inspektoratit të MMPH-së, edhe pse lidhur me vlerat e tejkaluara është iniciuar procedurë në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje, sipas informacioneve të tyre, lënda është parashkruar.

97. Meqenëse të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara në Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)<sup>23</sup>, Avokati i Popullit gjen që gjykata në rastin *Tătar v. Romania*, thekson që shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e qytetarëve duke rregulluar autorizimin e vendosjes, operimit, monitorimit të sigurt të aktivitetëve industriale, në veçanti aktivitetëve që paraqesin rrezik për mjedis dhe shëndetin e njeriut.

### **Zhurma**

98. Një ndër ankesat e vazhdueshme të banorëve në zonat në fjalë është edhe cenimi i së drejtës së privatësisë dhe së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm nga zhurma dhe vibrimet. Në disa vende të TC-ve, niveli i zhurmës ndonjëherë kalon 85 dB. Në afërsi të palosjes së hirit lajmërohen burime të shumta të zhurmës, të cilat ndikojnë në kualitetin e jetës së njerëzve që jetojnë në fshatrat përreth. Burimet e zhurmës të evidentuara janë: Ekskavatorët, mjetet transportuese (automjetet dhe shiritat transportues të linjitet/hirit), zhurma operative e termocentraleve Kosova A dhe B, operimi i lokomotivave të KEK-ut. Emetimet e zhurmës nga termocentralet vijnë kryesisht nga shiritat transportues, pajisjet për thërrmim, kazanët, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat e shumta, kullat ftohëse dhe oxhaqet. Në zona të ndryshme përreth pajisjeve të blloqeve të termocentraleve, niveli i zhurmës mund të tejkalojë vlerën prej 85 dB (decibelëve).

99. Përkundër ankesave të shumta të banorëve për zhurmën dhe vibrimet e liruara nga operatori, Avokati i Populli, vëren se shteti nuk ka arritur të gjejë zgjidhje efektive, e cila do të ishte mjet proporcional, për të balancuar interesat në mes të banorëve dhe industrisë. GJEDNJ, në rastin *Mileva and Others v. Bulgaria*, kishte gjetur shkelje të nenit 8 të konventës, pasi që shteti kishte dështuar ta drejtojë çështjen me kujdesin e duhur, dhe kështu të kryejnë obligim pozitiv për të siguruar respektimin e privatësisë, shtëpisë dhe familjes së

<sup>21</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re".

<sup>22</sup> Ankesa nr. 177/2013, Hetem Kutlllovci kundër MMPH.

<sup>23</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 53, [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

tij. Policia dhe autoritetet komunale kishin dështuar për ndërmarrjen e veprimeve për mbrojtjen e mirëqenies së qytetarit.

100. Situata është vështirësuar nga moszbatimi i ligjit për Mbrojtje nga Zhurma. Edhe pse vite me radhë janë duke u vërejtur probleme me zbatimin e legjislacionit aktual, projektligji që rregullon çështjen e zhurmës, ende nuk është miratuar.

101. Si rezultat i mosarritjes së organeve kompetente për të monitoruar nivelin e zhurmës<sup>24</sup>, dhe për të administruar situatat në raste të ankesave të banorëve, banorët janë obliguar të inicojnë procedura gjyqësore në mënyrë vetanake<sup>25</sup>. Mirëpo përkundër ndikimit të ndotjes në shëndetin e njeriut, Avokati i Popullit vëren që gjykata nuk arritur ta procedojë rastin sipas afateve të arsyeshme kohore. Edhe pas intervenimit të IAP-së lidhur me rëndësinë e trajtimit të rastit sipas afateve të parapara në nenin 6 të Konventës, Avokati i Popullit është njoftuar nga gjykata që rasti do të trajtohet sipas rendit, pa marrë parasysh natyrën e lëndës. Rasti i monitoruar nga Avokati i Popullit, i iniciuar në shtator 2013, me numër C.2193/13, lidhur me zhurmën dhe vibrimet, ende nuk ka përfunduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

102. Avokati i Popullit mungesën e monitorimit kualitativ e sheh si ndërhyrje e drejtpërdrejtë në të drejtat e njeriut. Gjykata rastin *Borysiewicz v. Poland*, e kishte shpallur të papranueshëm sipas nenit 8 të Konventës, pasi që nuk ishte arritur të vërtetohet që niveli i zhurmës së lejuar nuk kishte arritur pragun sipas rasteve mjedisore, pasi që pala nuk kishte ofruar asnjëherë raportet e monitorimit të zhurmës, si dhe dokumente dhe raporte mjekësore të cilat do të provonin ndikimin e zhurmës në shëndetin dhe familjen e saj. Mirëpo, gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së aplikantit për një proces të drejtë brenda një kohe të arsyeshme në bazë të nenit 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme), pasi që procedurat ishin duke zgjatur ende në gjykatën administrative vendore.

### **Deponitë, adminstrimi i mbeturinave**

103. Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina, i jep autoritet Ministrisë dhe komunës për administrimin e mbeturinave, ndërsa Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, menaxhimin e mbeturinave e lë si kompetencë vetanake dhe ekskluzive të komunës. Avokati i Popullit, gjatë daljes në terren, ka vërejtur që e tërë hapësira në fjalë është e përcjellë me grumbuj mbeturinash të llojeve të ndryshme, të vendosura pranë zonave të banimit dhe tokave bujqësore. Sipas informatave të pranuar nga MMPH, në komunën e Obiliqit, në vitin 2016, janë identifikuar edhe 55 deponi ilegale.

104. Në zonën në afërsi të Prishtinës (Dragodan) përreth deponisë së djerrinës si dhe deponisë së hirit afër Kosovës A, janë gjetur shumë deponi ilegale të mbeturinave si: mbeturina ndërtimore, mbeturina tjera nga termocentralet, shirita të vjetër gome, hekurishte etj.<sup>26</sup>. Në përfundim të deponisë së hirit, afro 200 metra nga fshati Dardhishtë, është përdorur

<sup>24</sup>PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", *Historikisht nuk ka të dhëna nga monitorimi i nivelit të zhurmës në afërsi të objekteve dhe pajisjeve, megjithëse niveli i zhurmës, si për të punësuarit ashtu edhe për banorët në brendësi të zonës energjetike, konsiderohet aspekt kyç që duhet trajtuar në kuadër të standardeve të BE-së dhe praktikave më të mira.*

<sup>25</sup> Ankesa 110/2015, Maliq Berisha dhe të tjerët, kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë.

<sup>26</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", Analiza gjeokimike përfshinte analizën e mostrave të tokës të marra në thellësi të ndryshme (nga 0.50 deri 80 metra) në 11 shpime të reja për përcaktimin e vlerës pH, kalciumit, magnezit, kaliumit, sodiumit dhe metaleve.

një pus i mëhershëm i ventilimit për deponimin e mbetjeve të katranit dhe fenolit. Kjo praktikë e njëjtë ka ndodhur edhe në miniera tjera të mëparshme nëntokësore. Veç kësaj, deponitë e hapura nuk kanë veshje adekuate apo pajisje tjera për mbrojtjen e tokës dhe nuk ka asnjë masë për zvogëlim të ndikimit për të shmangur kontaminimet e derdhjeve të ujërave nga reshjet e vrullshme dhe stuhitë.

105. Gjatë vitit 2018 është zhvilluar aksion vullnetar për mbledhjen e mbeturinave, i cili edhe pse e ka përmirësuar gjendjen nuk mundet të jetë mjet efektiv që do ta përmirësoj gjendjen.

#### **Deponia e mbeturinave sanitare “Mirash”**

106. Problemin e meanxhimit të deponisë së mbeturinave sanitare në Mirash<sup>27</sup>, IAP e ka përcjellë vite me radhë. Përkundër obligimeve të dala nga Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina, që parasheh administrim të duhur të mbeturinave, krijim të kushteve për parandalim dhe zvogëlim të prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre, vetëm me qëllim që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe i mjedisit, deponia vazhdon të operoj me probleme.

107. Mbeturinat e 7 komunave, komunës së Prishtinës, Drenasit, Podujevës, Gracanicës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës shkarkohen në deponinë e Mirashit. Deponia vazhdon të përcillet me problemet në vazhdim: shpërndarje të mbeturinave që vazhdojnë të shpërndahen pa penguar në ajër nga mos mbulimi i duhur, lirim i gazrave dhe kundërmim i vazhdueshëm nga shkarkimi i tyre nga mos menaxhimi i i duhur i mbeturinave sidomos atyre organike, sistem mos funksional i drenazhimit dhe i shkarkimit të gazrave që përbëjnë rrezik permanent për zjarre, mos menaxhimi i metanit, mos reciklimi i mbeturinave, përzierja me mbeturina inerte, mbeturina të veçanta dhe të rrezikshme, asbest, mbeturina medicinale, organike. Ndërsa, deponimi i thëngjillit në skajet e deponisë, paraqet rrezik të veçantë, të përhershëm për djege dhe rrezik jetën dhe sigurinë e qytetarëve.

108. Duke pasur parasysh që 40% e mbeturinave të deponuara në deponi janë mbeturina organike, e po ashtu aty deponohen mbeturinat e patrajtuara medicinale, kullimi i ujërave të patrajtuara nga deponia në lumin Sitnica dhe në ujërat nëntoksor, nga mungesa e sistemit funksional të drenazhimit, përbën kërcnim serioz për ndotjen e ujërave në vend. Sistemi i pompave është jashtë funksionit që nga viti 2007.

109. Sipas informatave të pranuar nga MMPH, AMMK, nga monitorimi i vazhdueshëm i Deponisë Sanitare në Mirash, ka gjetur se kjo deponi nuk menaxhohet në harmoni me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë fushën në fjalë. *“Parregullsitë në menaxhimin e deponisë, kanë ndikuar që gjysma e deponisë të jetë e mbushur çdo herë me ujë, mosmbulueshmeria me dheun në sipërfaqet e mbushura me mbeturina kanë ndikuar në kundërmim dhe në frekuentimin e shumë qenve endacakë, brejtësve dhe shpezëve, si bartës të sëmundjeve në zingjirin e sistemit ekologjik<sup>28</sup>”*. Sipas informatave të pranuar nga inspektorati i MMPH-së, inspektorarati në vazhdimësi ka inicuar procedura në gjykatë për keq menaxhim të deponisë

<sup>27</sup> Deponia regionale sanitare e mbeturinave në Mirash, është përgjegjësi e KMDK dhe menaxhohet nga KMDK.

<sup>28</sup> Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH-së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016

me shkelje ligjore, dhe që përkundër dëmit të shkaktuar mjedisor, lëndët në gjykatë/a janë parashkruar<sup>29</sup>.

110. Avokati i Popullit bazuar në monitorimin e gjatë të procedimit të lëndëve mjedisore në Prokurori dhe Gjykata, si nga individë po ashtu edhe organe kompetente, vlerëson që procedurat në fjalë nuk janë mjete efektive, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes, pasi që lëndët në fjalë nuk trajtohen me prioritet, përshkruhen dhe hidhen poshtë. Lidhur me çështjen e procedimit të lëndëve në prokurori dhe gjykata, Avokati i Popullit, më 22 nëntor 2018, ku morën pjesë përfaqësues të prokurorive, gjykatave, përfaqësues të organeve kompetente të nivelit qendror dhe lokal.

111. Ndërsa, sipas zyrtarëve të komunës së Obiliqit, përkundër gjendjes së deponisë ata nuk kanë inicuar asnjëherë çështjen në organet e drejtësisë, pasi që ata e konsiderojnë veten si jo kompetente për ti adresuar çështjet në gjykatë<sup>30</sup>, edhe pse deponija gjendet në komunën e tyre, Avokati i Popullit, tërheq vëmendjen në nenin 5 a) të Ligjit nr. 03/L- për Vetëqeverisjen Lokale, i cili përcakton statusin ligjor të komunës Komuna është së subjekt juridik që ka kompetenca, të padisë, ndërsa neni 17, I ligjit, saktëson që Kompetencë vetanake dhe ekskluzive e komunave sa i përket intëresit lokal është e) mbrojtjen e mjedisit lokal; dhe f) dhe menaxhimin e mbeturinave.

112. Avokati i Popullit, vëren që ende vazhdon deponimi i paklasifikuar i mbeturinave. Gjatë vizitës së bërë në deponinë e Mirashit, me rastin e xhirimit të emisionit Jeta në Kosovë, Avokati i Popullit, ishte dëshmitar i tentimit të deponimit të mbeturinave inerte/të ndërtimit.

113. Për më tepër, bazuar në hetimet lidhur me menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti, A. 12/2018, Avokati i Popullit ka vërejtur që organet kompetente nuk kanë arritur për të përmbushur obligimet e tyre për menaxhimin e materialeve me përmbajtje asbesti brenda territorit të vendit. Nga informatat u kuptua se asnjëra nga komunat (përveç Komunës së Mitrovicës) nuk ka caktuar lokacionet për deponimin e materialeve me përmbajtje asbesti.

114. Avokati i Popullit gjen që sipas dokumentit të Organizata Botërore e Shëndetësisë (ËHO), dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të publikuar në vitin 2007, që ka të bëjë me zhvillimin e programeve kombëtare për eliminimin e sëmundjeve të lidhura me asbest: "Ekspozimi ndaj asbestit shkakton asbestozë, pllaka pleurale, trashje dhe efusions, kancer të mushkërive, mesothelioma, laryngeal dhe ndoshta kanceret e tjera me periudha të ndryshme latente". Ndërsa sipas dokumentit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i publikuar në vitin 2014 "*Eliminimi i sëmundjeve të lidhura me asbestin*", i cili shqyrton efektet negative të ekspozimit të asbestit në shëndet, vlerësohet se të paktën 107 mijë njerëz vdesin çdo vit nga kanceri në mushkëri, si rezultat i ekspozimit në asbestozë gjatë ushtrimit të profesionit.

115. Praktika e GjEDNj-së, në kuadër të nenit 2 të Konventës [E drejta për jetën], jep mendimin që shteti duhet të vendosë detyrime pozitive për të marrë masat e nevojshme për të

---

<sup>29</sup> Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH-së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016, " *Kjo kompani në vazhdimisht është në agjendën inspektuese. Ndaj kësaj kompanie, inspektorati për shkeljeve ligjore ka ushtruar procedure për kundërvajtje në gjykatë në vitin 2008, 2009, 2011 por si zakonisht lëndët në gjykatë janë parashkruar*".

<sup>30</sup> <https://kallxo.com/video-deponia-e-mirashit/>, Emisioni Jeta në Kosovë, "Deponia e Mirashi", 24 maj 2018.

mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridiksionit të tij<sup>31</sup>. Neni 2 i obligon autoritetet publike të ndërmarrin hapa për të garantuar të drejtat e Konventës, madje edhe kur të drejtat kërcënohen nga persona të tjerë (privatë) ose aktivitetet që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me shtetin. Sipas Gjykatës, obligimi pozitiv i shteteve mund të aplikohet në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme, funksionimit të fabrikave të kimikateve me emetime toksike, ose vendeve të grumbullimit të mbetjeve, qoftë të transportuara nga vetë autoritetet publike ose nga kompani private. Në përgjithësi, shkalla e detyrimeve të autoriteteve publike varet nga faktorët se sa është ndikimi i aktiviteteve të rrezikshme dhe parashikimi i rrezikut për të jetën<sup>32</sup>.

116. Ligji për Mbeturinat obligon qeverinë që në rastet kur gjendja e mbeturinave paraqet rrezik për shëndetin dhe mjedisin të ndërmarr masa të shpejta për të parandaluar gjendjen.

117. GJEDNJ, përkitazi me bezdinë nga era, zhurma, dhe tymi, i shkaktuar nga deponia e vendosur afër shtëpive të banimit, është shprehur, se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, duke gjetur se shteti nuk ka arritur të ekuilibrojë drejt interesat në mes mirëqenies ekonomike të qytetit dhe gëzimit efektiv të së drejtës së qytetarëve për të respektuar shtëpinë, privatësinë dhe familjen<sup>33</sup>.

118. Mirëpo, shqetësim kryesor lidhur me çështjen e deponisë së Mirashit, është çështja e rrezikut të shkarkimit dhe depërtimit të ujërave të kontaminuar nga deponia në lumin Lepenc dhe në ujërat nëntokësor. Kjo çështje do të paraqiste një problem të pasanueshëm, katastrofë mjedisore, me ndikim në të drejtën e jetës së qytetarëve, në të drejtën për ujë të pijshëm, e mbi të gjitha të drejtën për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm.

119. Andaj, duke u bazuar në faktet e përmendura më lartë, e drejta e jetës, e drejta e privatësisë, e gëzimit të shtëpisë, dhe e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, dhe e drejta për ujë të pijshëm e qytetarëve është cenuar në vazhdimësi nga keq menaxhimi, mosmbulimi dhe moskompaktimi me rregull i mbeturinave, kundërmimi, tymi, shkarkimi i pakontrolluar dhe rrjedhja e ujërave të zeza nga mos arritja dhe papërgjegjësia e organeve kompetente për ndërmarrjen e masave efektive, lidhur me çështjen.

### **Deponia e hirit**

120. Hiri është problemi më i madh në aspektin e sasisë dhe sipërfaqes së zënë me deponitë ekzistuese. Mostrajtimi i mirë i këtyre deponimeve të hirit paraqet problem shumë serioz social dhe mjedisor për zonën me interes të veçantë<sup>34</sup>.

121. Hulumtimet e zhvilluara kanë gjetur prani të pikave të nxehta me nivel të lartë të mbetjeve fenolike, ujërave fenolik dhe prani të katranit në deponinë e hirit të “Kosovës A”, edhe pse deponia nuk është përdorur në baza të rregullta për deponimin e këtyre materieve. Hiri i depozituar në deponi të hirit përmban nivele të ngritura të metaleve të rënda, por për shkak të përbërjes kimike të hirit, potenciali për kullim është i kufizuar.

122. Sipas Komunes së Obiliqit, deponia e hirit është ndër ndotësit kryesorë të ajrit.

<sup>31</sup> *L.C.B. v. the United Kingdom, judgment of 9 June 1998, paragraph 36;*

<sup>32</sup> *Öneriyıldız v. Turkey [GC], paragraph 73; L.C.B. v. the United Kingdom, paragraphs 37-41.*

<sup>33</sup> *Lopez Ostra v. Spain*

<sup>34</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

123. Deponia e hirit është në fazën e rehabilitimit, kurse depozitimet e reja të hirit bëhen përmes sistemit hidraulik, dhe nuk ka shpërndarje të pluhurit. Edhe pse gjatë vitit 2015 është vazhduar me procesin e rikultivimit të deponive të hirit dhe djerrinës, është ngritur brezi i gjelbër në pjesën perëndimore në minierë<sup>35</sup>, vërehet që rehabilitimi dhe përmirësimi mjedisor, duke filluar me largimin dhe rikultivimin e zonave të hirit të deponuar, të palosjeve të jashtme të djerrinës, duke vazhduar me rehabilitime të zonave të degraduara dhe të minierave të shfrytëzuara, ndërtimi i barrierave për mbrojtje nga vërshimi, erozioni, dridhjet dhe zhurma, e sidomos krijimi i brezit rrethues të zonës minerare dhe gjeneruese energjetike nga gjelbërimi në kuadër të këtij procesi, që janë të obligueshme<sup>36</sup>, është duke vazhduar me hapa të ngadalësuar. .

### **Shtëpia e banuar brenda hapësirës së KEK-ut**

124. Avokati i Popullit, gjatë vizitës së komunës së Obiliqit, ka vizituar familjen Morina në fshatin Palaj. Prona e familjes gjendet brenda hapësirës së rrethuar nga KEK-u. Përkundër garancisë kushtetuese që “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”, të gjithë anëtarëve të familjes dhe vizitorëve të tyre, qasja në pronë/shtëpi u kufizohet në vazhdimësi, nga vendosja e laurës së kontrollës të sigurimit të KEK-ut, në rrugë 40-50 m para shtëpisë së tyre.

125. Edhe pse Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (neni 1, paragrafi 2) “siguron qeverisje të qëndrueshme ... parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët”, Avokati i Popullit vlerëson që familjes në fjalë i kufizohet lëvizja e lirë, meqenëse ata në vazhdimësi kufizohen të kenë qasje të papenguar në pronën e tyre.

126. Sipas Avokati i Popullit, përveç kufizimit të lirisë së lëvizjes nga nënshtrimi i kontrolleve të bezdishme të përhershme të anëtarëve të familjes Morina, atyre u kufizohet edhe e drejta e privatësisë. Sipas GJEDNJ-së, shfrytëzimi i kompetencave detyruese, të parapara në legjisllacion për t'i kërkuar individit që të bëjë kontrollin e hollësishëm të personit, të veshmbathjeve të tij dhe gjësendeve të tij personale derisa ec në rrugë është konstatuar të jetë ndërhyrje me të drejtën për respektimin e jetës private<sup>37</sup>.

127. Duke pas parasysh që kontrolli bëhet në rrugë të hapur, Avokati i Popullit vëren se GJEDNJ thekson fakti se kontrolli bëhet në vend publik nuk e bën të pazbatueshëm nenin 8. Në fakt, sipas pikëpamjes së Gjykatës, natyra publike e bastisjes në raste të caktuara mund të rrisë shkallën e ndërhyrjes për shkak të elementit të poshtërimit dhe turpërimit. Gjësendet, siç janë çantat, kuletat, fletoret dhe ditarët, për më tepër mund të përmbajnë gjëra personale, pronari i të cilave mund të ndjehet i parehatshëm nëse të tjerët i shohin ato<sup>38</sup>

<sup>35</sup> Po aty, M.S. Sibovc- JP, me gjatësi 1500(m) gjegjësisht sipërfaqe prej S=2 (ha). Gjithsej janë mbjellë 1025 fidanë, varietete të ndryshme

<sup>36</sup> PLANI HAPËSINOR 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

<sup>37</sup> Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>38</sup> [http://www.coe.int/t/dgi/hr-natimplement/Source/documentation/hb11\\_privatelifelife\\_alb.pdf](http://www.coe.int/t/dgi/hr-natimplement/Source/documentation/hb11_privatelifelife_alb.pdf), Mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, Doracakët për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, fq. 20.

128. Edhe pse situata zgjat vite me radhë, Avokati i Popullit vëren që asnjërës nga organet përgjegjëse nuk u ka shkuar mendja, madje që lënia e shtëpisë brenda hapësirës në fjalë, ka cenuar rëndë të drejtat e anëtarëve të familjes.

129. Mirëpo, problemet më serioze me të cilat janë duke u ballafaquar familja Morina, janë problemet shëndetësore të dy fëmijëve të familjes. Ata, mbase si rezultat i ndikimit të pluhurit të liruuar në ajër nga mihja, vuajnë nga problemet me organe respiratore.

### **Mungesa e Bashkëpunimit ndërinstytucional dhe inspektorateve**

130. Avokati i Popullit, duke e përcjellë punën e organeve kompetente për zbatimin e legjislacionit mjedisor, përkitazi me problemet me ndërtime pa leje në zonën e interesit të veçantë; ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës; problemet me zhurmën; problemet e evidentuar në deponinë regjionale dhe deponitë tjera; mos gjetjen e e zgjidhjes së probleme të shkaktuar në vendbanimet sociale, nga eksplodimi i vitit 2014; ka vërejtur që organet kompetente janë munduar gjithnjë që mosgatishmërinë e tyre për veprim ta emërojnë si inkompetencë për zbatim të ligjeve që rregullojnë fushat e veçanta mjedisore, me tendencë që kompetencën t'ia kalojnë organit tjetër.

131. Lidhur me çështje të ndryshme mjedisore, niveli komunal, mosveprimin dhe neglizhencën e ka arsyetuar si mosveprim për arsye të inkompetencës, duke ia bartur përgjegjësinë nivelit qendror.

132. Avokati i Popullit gjen që Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (ligj ombrellë) në nenin 5, paragrafi 3.3. autorizon komunitat të *“zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre”*. Ndërsa, neni 81, paragrafi 1 i këtij ligji parasheh që *“Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati mjedisor i Ministrisë”*, duke paraparë që *“Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizojë inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera”* (neni 3) dhe që *“Punët e inspektorit mund t'i kryejë edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna”* (neni 4).

133. Mirëpo, ligji duke paraparë situata që nuk mund të menaxhohen vetëm nga një kategori inspektorësh dhe organeve kompetente, me dispozitë të veçantë parasheh detyrimet e e inspektorëve për bashkëveprim, saktëson që *“Në rastet kur inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese vlerëson se përveç shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, janë shkelur edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, është i detyruar që krahas marrjes së masave për të cilat është i autorizuar, të njoftojë edhe organin tjetër kompetent në mënyrë që bashkërisht të kryejnë mbikëqyrjen inspektuese dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj”*, nuk u lë organeve kompetente vend për arsyetim për inkompetencë, në rastet e mosveprimit.

134. Në rastet kur është i domosdoshëm mënjanimi i rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, çrregullimet mjedisore ose të pronës me vlerë të veçantë, ose në rastet kur është e domosdoshme për shkak të ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes ose të rëndësisë së mënjanimit të mangësive, Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës,

Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, po ashtu parasheh obligimin për bashkëpunim, paraparë që mbikëqyrja mund të kryhet njëkohësisht nga më shumë organe inspektuese.

135. Mbrojtja e mjedisit është esenciale për mirëqenien e njeriut, por edhe respektimin e të drejtave themelore të qytetarëve, përfshi edhe të drejtën për jetën. Avokati i Popullit konsideron se inspektoratet e nivelit qendror dhe nivelit lokal nuk kanë bashkëpunuar mjaftueshëm në mënyrë që të parandalojnë, ndalojnë madje edhe të ndërprejnë veprimtaritë e rrezikshme për mjedisin jetësor, me ndikim në të drejtat e banorëve.

### **Shqyrtimi i rasteve mjedisore brenda afateve të arsyeshme kohore në prokurori dhe gjykata dhe parashkrimi i tyre**

136. Përkundër ndikimit të ndotjes në të drejtat e njeriut, në shëndetin publik, peshës së dëmit të shkaktuar në mjedis, prokuroritë dhe gjykatat nuk kanë arritur të krijojnë strategji, e cila do të siguronte shqyrtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me mjedisin, brenda afateve të arsyeshme kohore, dhe marrjen e vendimeve të zbatueshme dhe të bazuara në ligj, të cilat do të ishin vendime proporcionale me dëmin e shkaktuar, dhe njëherësh do të arrinin efektin për ndërprejen e shkakut të dëmit, si dhe ndërmarrjen e masave proporcionale për rehabilitim dhe sanim. Marrja e vendimeve brenda afateve të arsyeshme kohore, do të ishte mjet efektiv për parandalimin e problemeve mjedisore.

137. Parashkrimi i vazhdueshëm i rasteve të inicuar nga inspektoratet në prokurori dhe gjykata është shqetësim i vazhdueshëm i inspektorateve mjedisore të nivelit qendror dhe lokal.

138. Edhe pse çështja e zvarritjes së lëndëve mjedisore në prokurori dhe në gjykata, po ashtu edhe parashkrimi i tyre është ngritur shumë herë nga Inspektoratet Mjedisore të nivelit qendror dhe lokal, Avokati i Popullit, edhe pse kërkoi nga të gjitha komunat dhe nga MMPH, numrin e lëndëve të inicuar në prokurori dhe gjykata, nuk pranoi asnjë përgjigje.

139. Avokatit të Popullit, organizoi tryezën *“Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”*. Qëllimi i të cilës ishte diskutimi i arsyes së zvarritjes së lëndëve mjedisore në Prokurori dhe Gjykatë. Nga diskutimi u kuptua se as sistemi prokurorial dhe as ai gjyqësor nuk kanë statistika lidhur me këto raste, nuk është diskutuar asnjëherë lidhur me çështjen, dhe që krimet mjedisore zakonisht lidhen me rastet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, dhe që numri i rasteve të mjedisore është i vogël.

140. Edhe pse njëra ndër tri parimet përmes së cilave realizohen të drejtat mjedisore, Parimi i qasjes në drejtësi, apo e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, e paraparë në Konventën Aarhus, është e integruar në tërë legjislacionin mjedisor, realizimi i të drejtave për çështje mjedisore në gjykata dhe prokurori është duke u përcjellë në vend me shumë vështirësi.

141. Duke u bazuar në faktet e sipërpërmendura, si parashkrimi, kategorizimi i ndotjeve dhe dëmeve mjedisore si kundërvajtje, gjobat e ulëta, janë treguar si mjete joefektive dhe masa jo proporcionale për parandalimin, pengimin, sanimin dhe rehabilitimin e gjendjes së krijuar mjedisore, që është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, qëllimi i të cilit është krijimi i standardeve mjedisore në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian.



## Mungesa e informatave mjedisore

142. Edhe pse e drejta për informim është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]: *"1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike"*, e një ndër parimet në të cilat bazohet Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, është parimi i qasjes së publikut në informata, nenin 6 (*"Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje"*), AP, pas hetimit, analizës, dhe shqyrtimit të çështjes, ka vërejtur **që zanafillë e gjithë problemeve**, është mungesa e informimit konkret dhe me kohë lidhur me gjendjen e mjedisit.

143. Sikurse nga përcjellja e rastit në terren, e po ashtu nga përgjigjet e pranuar nga MMPH, nga Komuna e Obiliqit, vërehet se qytetarët nuk kanë pasur dhe nuk kanë informim të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit. Informimi i publikut, sipas Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), bëhet përmes raporteve mujore, periodike dhe vjetore. Mirëpo, informim të vazhdueshëm të përditësuar nuk ka<sup>39</sup>.

144. Përkundër obligimit ligjor që derivon nga neni 54, par.1 i Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, që obligon institucionet përgjegjëse të paralajmërojnë publikun në rastet kur niveli i ndotjes tejkalon parametrat e gjendjes normale (*"Ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuara dhe të tjera, janë të detyruara që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, respektivisht për dukuritë të cilat janë duke u përcjellë në kuadër të monitorimit të emisionit dhe cilësisë të mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut, në përputhje me ligj"*), organet përgjegjëse, MMPH, MSH, IKSHPK, komuna, por edhe operatorët, kanë dështuar të përmbushin obligimin e tyre pozitiv, për të informuar publikun lidhur me gjendjen në mjedis, sidomos në ditët kur regjistrohen tejkalime si dhe mënyrat e ndërmarrjes së masave preventive, si të domosdoshme për kategorinë e qytetarëve të prekur me sëmundjet kardiovaskulare, të organeve respiratore dhe atyre me sëmundje malinje.

145. Edhe pse është obligim ligjor krijimi i një sistemi unik dhe të integruar të informimit shëndetësor nën gjithë sektorin e shëndetësisë, i cili do të t'i ishte një indikator i ndikimit të ndotjes në shëndetin e qytetarëve, ende nuk është funksionalizuar.

146. Avokati i Popullit gjen që neni 2 dhe 8 i Konventës iu imponon institucioneve shtetërore obligimin specifik pozitiv të sigurimit të qasjes në informacione lidhur me çështjet mjedisore. Kjo detyrë e autoriteteve publike për të siguruar qasje në informacione, si obligim pozitiv duhet të zbatohet sidomos lidhur me personat të cilëve e drejta për jetën, privatësinë, e drejta familjare dhe e gëzimit të shtëpisë u cenohet. Gjykata u shpreh se shtetet janë të detyruara në bazë të nenit 2 të Konventës që të *"informojnë në mënyrë adekuate publikun në lidhje me ndonjë emergjencë që përbën kërcënim emergjent për jetën..."*.

147. Avokati i Popullit konsideron që për t'u respektuar e drejta e çdo njeriu për mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, por njëherësh për t'i përmbushur detyrat e të

---

<sup>39</sup> *Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH-së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016, pyetja nr.2 A keni ndërmarrë masa paralajmëruese ...që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut?*

gjithëve për mbrojtën dhe përmirësimin e mjedisit për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, qytetarët duhet të kenë qasje në informata mjedisore, e cila do t'u garantonte pjesëmarrje në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi në çështjet e mjedisit.

148. Përmirësimi i qasjes në informata të fushës së mjedisit do të ndikonte në përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, duke rritur cilësinë dhe zbatimin e vendimeve, do të kontribuonte në ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet e mjedisit, dhe do t'u hapte qytetarëve mundësinë për të shprehur shqetësimet e tyre<sup>40</sup>.

149. Mirëpo, përveç që qytetarët duhet të kenë qasje të mjaftueshme në informatat mjedisore, ata duhet të dinë si t'i përdorin ato. Duke vënë në dukje, në këtë kontekst, rëndësinë e përdorimit të mediave dhe formave elektronike apo të tjera të ardhshme të komunikimit.

150. Edhe pse në periudhën nëntor-shkurt qytetarët e komunës së Obiliqit, por edhe të komunave përreth, sidomos ata të Prishtinës, janë duke u ballafaquar me ndotje alarmante të ajrit, para vetes nuk kanë informata të cilat do të ishin bindëse, të sakta dhe do të përmbanin instruksione për marrjen e masave preventive.

151. Dy vitet e fundit Avokati i Popullit ka evidentuar disa herë informata që kanë të bëjnë me gjendjen e ajrit në periudhën nëntor-shkurt. Edhe pse informatat kanë të bëjnë me gjendjen e ajrit në komunën e Prishtinës, Avokati i Popullit, i merr si relevante me çështjen që është subjekt i analizës, për arsye të afërsisë së dy komunave. Më 24 nëntor 2016, qytetarët përmes portaleve janë njoftuar se "Kryeqyteti futet në vijën e kuqe me ndotje ajri", më 29 nëntor 2016, "AMMK thotë se cilësia e ajrit është përmirësuar në Prishtinë"<sup>41</sup>, më 1 dhjetor 2016, qytetarët janë njoftuar se "Tri lagje të Prishtinës me ndotje enorme me sulfur hidrogjeni"<sup>42</sup>, më 2 dhjetor 2016, se "Prishtina me ajër të dëmshëm për shëndetin"<sup>43</sup>, më 4 dhjetor 2016, "Ajri në Prishtinë sot jo i shëndetshëm"<sup>44</sup>, sipas së cilës qendra për matjen e cilësisë së ajrit, e vendosur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, kishte raportuar se ajri ishte jo i shëndetshëm për grupe të personave të ndjeshëm, cilësia e ajrit është 146 ppm, dhe se anëtarët e grupeve të ndjeshme mund të përjetojnë efekte shëndetësore, por publiku në përgjithësi nuk do të preket. Të rriturit dhe fëmijët aktivë, si dhe njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes, si astma, duhet të kufizojnë ushtrimet e zgjatura në natyrë.

152. Gjendja e ngjashme e përcolli edhe fundin e vitit 2017 dhe fillimin e vitit 2018, dhe përkundër mobilizimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, qytetarët vazhduan të ballafaqohen me informata të mangëta, dhe jo nga institucionet kompetente.

153. Mirëpo edhe pse informatat e lartpërmendura janë informata shqetësuese, përbëjnë kërcënim për rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin<sup>45</sup>, AP konstaton se organet kompetente AMMK, apo edhe MMPH, nuk i është drejtuar publikut menjëherë dhe

---

<sup>40</sup> Convention On Access To Information, Public Participation In Decision-Making And Access To Justice In Environmental Matters Done At Aarhus, Denmark, On 25 June 1998

<sup>41</sup> <http://koha.net/?id=8&l=144769>, datë 29 nëntor 2016,

<sup>42</sup> <http://koha.net/?id=8&l=145089>, datë 1 dhjetor 2016,

<sup>43</sup> <https://koha.net/?id=27&l=145304>, datë 2 dhjetor 2016,

<sup>44</sup> <http://koha.net/?id=8&l=145600>, datë 4 dhjetor 2016,

<sup>45</sup> Convention On Access To Information, Public Participation In Decision-Making And Access To Justice In Environmental Matters Done At Aarhus, Denmark, On 25 June 1998, article 5.c.

pa vonesë përmes mjeteve të qasshme të informimit, për t'i njoftuar për ndërmarrjen e masave parandaluese, ose masave për zbutjen e ndotjes. Ditëve të fundit, edhe pse vërehet përkeqësim i gjendjes, janë vërejtur reagime përmes mediave sociale nga faqet e kryesuesve e AMMK-së, dhe IHK, por jo mjaftueshëm përmes faqeve zyrtare të institucioneve, që do të përbënin informatë zyrtare dhe relevante.

154. Avokati i Popullit, duke u bazuar në informatat zyrtare të AMMK-së, MSH, IKSHPK, dhe dokumentit të OBSH<sup>46</sup>, konstaton se organet kompetente duke mos pasur monitorim cilësor, kanë dështuar dhe janë duke dështuar për të informuar qytetarët në vazhdimësi për gjendjen e ajrit, me informata të përditësuara dhe kualitative, dhe përmes mjeteve të qasshme.

### **Mungesa e informatave shëndetësore**

155. Avokati Popullit vëren se përkundër informacioneve<sup>47</sup> të ndryshme lidhur me ngritjen e numrit të të prekurve nga sëmundjet e organeve respiratore, kardiovaskulare dhe malinje, sëmundjeve të lëkurës, në territorin në fjalë<sup>48</sup>, organet kompetente nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar statistika dhe për të bërë hulumtime të veçanta, të cilat do të paraqisnin numrin real të kategorive në fjalë, si dhe do të ishin indikatorë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për edukimin dhe parandalimin e ndikimit të popullata.

156. Sipas informatës së pranuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), vërehet se ky Institut posedonte vetëm të dhëna në bazë të rasteve të raportuara nga institucionet shëndetësore në nivel vendi, por që sipas tyre, ato të dhëna nuk janë të plota dhe jo shumë të besueshme, për shkak se *"sistemi i integruar i informimit shëndetsor në Kosovë është në fazën e e pilotimit, nga Ministria e Shëndetësisë, ... dhe se koordinatorja e SISH, në QKM Obiliq, ka probleme me grumbullimin e të dhënave për arsye ..."*<sup>49</sup>.

157. Mirëpo, Avokati i Popullit nuk vëren dhe as nuk posedon asnjë informatë që organet kompetente kanë ndërmarrë veprime konkrete për të analizuar dhe vlerësuar<sup>50</sup> situatën përkundër zërave se numri i të prekurve me sëmundje malinje<sup>51</sup>, kardiovaskulare dhe nga organet respiratore është rritur nga ndikimi i gjendjes së mjedisit<sup>52</sup>.

---

<sup>46</sup> Ndërtimi i së ardhmes më të mirë për qytetarët e Fushë Kosovës dhe Obiliqit: Pjesëmarrja, Mbrojtja dhe Partneritetet Shumetnike për Arsim, Shëndetësi më të mirë dhe Amvisëri më të Qëndrueshme, Zyra Rajonale e OBSHsë për Evropë ka realizuar një mision në Kosovë, tetor të vitit 2012.

<sup>47</sup> Ndërtimi i së ardhmes më të mirë për qytetarët e Fushë Kosovës dhe Obiliqit: Pjesëmarrja, Mbrojtja dhe Partneritetet Shumetnike për Arsim, Shëndetësi më të mirë dhe Amvisëri më të Qëndrueshme, Zyra Rajonale e OBSHsë për Evropë ka realizuar një mision në Kosovë, tetor të vitit 2012.

<sup>48</sup> [http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/204585/1/9789241565196\\_eng.pdf?ua=1](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/204585/1/9789241565196_eng.pdf?ua=1) "In 2012, this present study estimates, 12.6 million deaths globally, representing 23% (95% CI: 13–34%) of all deaths, were attributable to the environment".

<sup>49</sup> *Informatë e pranuar në përgjigjen nga Prof. Dr. Naser Ramadani, ISHPK, , në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 4 tetor 2016.*

<sup>50</sup> Ligji Nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësi Publike neni 4.2 " Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike si në vijim... Analizimit, vlerësimit dhe menaxhimit të mbrojtjes shëndetësore të kategorive të veçanta të popullatës me rëndësi sociale mjekësore si dhe sëmundjet malinje, kardiovaskulare, diabeti e të ngjashme;

<sup>51</sup> <http://telegrafi.com/alarmante-rreth-700-raste-te-reja-kancer-per-7-muaj/>

<sup>52</sup> *Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH-së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016, "Tejkalimet e emisioneve çdo herë paraqesin rrezik për sistemin ekologjik dhe njeriun në veçanti. Studimet e shumta tregojnë se tejkalimet e shkarkuar të emisioneve në mjedise paraqesin rrezik për mjedisin në*

158. Avokati i Popullit, gjatë hetimit të rastit, nuk ka hasur dhe as nuk i është ofruar asnjë dëshmi nga organet kompetente<sup>53</sup> që do të dëshmonte obligimin e tyre pozitiv për të hulumtimin e ndikimit të faktorëve mjedisorë në shëndetin e popullsisë në komunën e Obiliqit, dhe komunave afër, edhe pse territori i kësaj komune për vite me radhë është evidentuar si *hot spot*. Hulumtimet e tilla do të hapnin rrugën për propozimin e masave mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme në shëndet.

159. Në rastin konkret, duke pasur parasysh që tejkalime janë regjistruar vite me radhë, dhe situata e gjendjes së mjedisit do të ketë mundësi për pasoja shëndetësore për popullatën<sup>54</sup>, masa konkrete nuk janë ndërmarrë. AP konsideron se shteti ka dështuar të përmbushë obligimin pozitiv për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe privatësisë së qytetarëve. GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 2 [E drejta e jetës], nenit 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të Konventës<sup>55</sup> në rastet kur shteti ka dështuar të përmbushë obligimin pozitiv për ndërmarrjen e masave për mbrojtje adekuate dhe për të informuar me rrezikun për shëndetin dhe jetën e banorëve në rastet që paraqesin rrezik.

160. Avokati i Popullit gjen që popullata, nuk është njoftuar në masën e duhur për ndikimin e ndotjes së mjedisit të cilat mund të kërcënojnë shëndetin<sup>56</sup>.

161. Edhe pse është obligim ligjor i IKSHP-së, hulumtimi i shkaqeve dhe pasojave të ajrndotjes dhe dëmtimi në shëndetin publik, si dhe propozimi i masave mbrojtëse, Avokati i Popullit, deri në ditën e publikimit të raportit, nuk ka hasur në ndonjë publikim nga IKSHPK, i cili do të dëshmonte ndikimin e këtyre ndotësve në shëndetin e njeriut<sup>57</sup>.

162. GJEDNJ thekson se kur autoritetet publike vërejnë se kryhen aktivitete të rrezikshme të cilat ata e dinë që përbëjnë rrezik dhe dëm për shëndetin, ata duhet të krijojnë procedurë efektive dhe të arritshme që u mundëson individëve të kërkojnë të gjitha informatat relevante dhe të përshtatshme. Publiku duhet të ketë qasje në rezultatet e studimit të ndikimit të vlerësimit të mjedisit në shëndet.

163. Duke u bazuar në paragrafët e lartpërmendur, Avokati i Popullit konkludon që shteti ka dështuar të përmbushë në vazhdimësi obligimin e tij pozitiv për të informuar publikun në vazhdimësi lidhur me gjendjen e mjedisit dhe ndikimit në shëndetin publik. Informimi i

---

*përgjithësi. Aktualisht, nuk ka ndonjë studim i veçantë për ndikimin në shëndet nga ndotja e mjedisit, edhe pse do të duhej të kryhej nga IKSHPK.*

<sup>53</sup> *Po aty, Shëndeti Mjedisor dhe Banimi neni 6 6.1 IKSHPK hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet. 6.2 IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet. 6.3 Brenda sferës së aktiviteteve të lidhura me shëndetin e mjedisit dhe atij të banimit, IKSHPK do të: a)njoftoj popullatën lidhur me shkaqet e ndotjes së mjedisit i cili mund të kërcënon shëndetin.*

<sup>54</sup> Prononcim zyrtar, prof. Behxhet Mustafa, emisioni Euro Tribuna, pj.2, min. 22 <https://www.youtube.com/watch?v=eQc2A0Oc1Ië>, citim “çështja e mjedisit në afatgjat do të ketë pasoja mjedisore”

<sup>55</sup> *Brincat and others v Malta*

<sup>56</sup> Informatë e pranuar nga përfaqësuesit e MMPH, komuna e Obiliqit, dhe menaxhmenti i KEK. Datë, 4 tetor 2016.

<sup>57</sup> Ndotësit ndikojnë në shëndetin e njeriut, deklaram i z. Ilir Morina , Kryeshef i AMMK-së, në Komisioni i Kuvendit të Kosovës, për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

deritanishëm nuk është proceduar në mënyrë efektive e cila do të ishte e arritshme në çdo kohë.

164. Mos regjistrimi i asnjë rasti të informimit të publikut, përmes mjeteve të informimit, për situatat kur janë regjistruar tejkalimet e ndotësve, mungesa e analizimit dhe e hulumtimit paraqet mos përmbushje të obligimeve ligjore, dhe mosveprim në detyrë zyrtare karshi qytetarëve. Mungesa e informatave ka bërë që qytetarët të ballafaqohen me ankthin lidhur me gjendjen e mjedisit, si dhe pamundësinë për të vlerësuar rrezikun nga mjedisi në të cilin ata janë të ekspozuar.

### **Përfundim**

Avokati i Popullit, duke bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura në këtë raport, konkludon se të drejtat dhe liritë e qytetarëve që banojnë në territorin rreth KEK, janë cenuar në vazhdimësi nga mos arritja e përmbushjes së obligimit pozitive të shtetit, për balansim të drejt në mes të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke konstatuar se qytetarëve i është mohuar e drejta për mjedis të sigurt dhe shëndetshëm, Dinjiteti i Njeriut, E Drejta për Jetën, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, E Drejta për Mjete Juridike, Liria e Lëvizjes, E Drejta e Privatësisë, E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike, dhe e Drejta e Pronës, me qëllim që shteti të filloj të përmbush obligimet e veta pozitive, Avokati i Popullit në pajtim, me nenin 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27, të Ligjit nr. 05/L-019, për Avokatin e Popullit,

### **REKOMANDON**

- *MMPH/Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës me hapa të përshpejtuar të përmirësorë procesin e monitorimit të ajrit;*
- *MMPH të ndërmarrë aktivitete edukuese në mënyrë që qytetarët të vetëdijesohen për ndikimin negativ të ajrit të ndotur në shëndet, si dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave preventive;*
- *MMPH/Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, të fillojë me informim të përditësuar për kualitetin e ajrit;*
- *MMPH të përmirësoi sistemin e monitorimit të ujërave, të gjendet zgjidhje për trajtimin e ujërave dhe të investohet në impiante;*
- *MMPH të ndajë fonde shtesë për rehabilitimin e sipërfaqeve me norma të tejkaluara të ndotjes dhe të bëjë vlerësimin për zhvendosje të banorëve nga zonat ku ka tejkalime enorme, me mundësi të ndikimit në shëndetin e njeriut;*
- *MMPH të vazhdoi ndërmarrjen e masave për zhvendosjen e deponive ilegale dhe trajtimin e mbeturinave sikurse parashihet me legjislacionin në fuqi;*
- *MMPH të ndërmarr veprime në drejtim të hartimit të politikave për klasifikimin e mbeturinave sipas përmbajtjes së tyre;*
- *KEK-u të ndërmarr veprime në drejtim të rehabilitimit dhe gjelbërimit të hapësirës së degraduar me qëllim të minimizimit të përhapjes së pluhurit në ajër, si dhe*

*Inspektorati komunal i Komunës së Obiliqit dhe inspektorati i MMPH-së të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen në këto hapësira;*

- *Komuna e Obiliqit të kërkojë nga KEK që të zgjidhë çështjen e familjes Morina (të kërkojë nga KEK-u të ndalojë kontrollin e paautorizuar të familjes, apo zhvendosjen apo shpronësimin e pronës së familjes Morina);*
- *Këshilli Prokurorial i Kosovës - prokurorët pa vonesa t'i procedojnë të gjitha parashtrësit e qytetarëve dhe institucioneve, për veprat penale për ndotje mjedisore nga individët, kompanitë publike dhe private;*
- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës – gjykatat të shqyrtojnë të gjitha lëndët lidhur me ndotjen e mjedisit, t'i trajtojnë në afate ligjore, pa zvarritje dhe ashtu që të mos të vije deri të parashkrimi i tyre;*
- *Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës të dalë me hulumtim lidhur me ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin e popullsisë jo vetëm në komunën e Obiliqit, por edhe më gjerë.*

Në pajtim me nenin 132, parag.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

  
Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit